



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:149343
Datë: 08.02.2024
Numri i dokumentit: 05303235

KPPP.nr.1028/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “EDILON” Sh.P.K me adresë në rrugën “Skëndërbeu”, Komuna e Gjakovës, me NUI: 810232596, kundër debitorit “Gastroteca Republika” Sh.P.K., me adresë në rrugën “Fan Stilian Noli”, Komuna e Gjakovës, me NUI: 811488429, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.347/23 të datës 22.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datë 29.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Gastroteca Republika” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.347/23 të datës 22.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.347/23 të datës 22.06.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturave: Faturës nr.01/2023 të datës 23.01.2023, dhe Faturës nr.04/2023 të datës 26.04.2023, duke urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit për përmbartim, t’ia bëjë pagesën e borxhit të mbetur kreditorit në shumën prej 9,515.00 Euro, me kamatë ligjore nga dita e lëshimit të

faturave deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, për shkak se Përbaruesi i çështjes ka vepruar në kundërshtim me nenin 37 dhe 38.1 të LPP-së, me arsyetimin se aktgjykimet nuk janë treguar në versionin origjinal, apo të njejtat të jenë identike me origjinalin, respektivisht të noterizuara tek noteri, siç kërkohet me ligjin në fuqi. Ka theksuar se urdhri përbarues nuk ka tipare të përbarueshmërisë, për faktin se është lejuar një propozim për përbarim i cili nuk është konform LPP-së, duke shtuar se fatura është fiktive për faktin se kreditori nuk ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj debitorit në bazë të marrëveshjes, veprimet e kreditorit kanë për qëllim të begatimit pa bazë. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi, dhe të anulohet urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk ekzistojnë, sepse në shkresat e lëndës janë faturat origjinale të nënshkruara dhe të vulosura nga kreditori dhe nga debitori. Ka shtuar se urdhri përbarues është lejuar në bazë të faturave të rregullta dhe të ligjshme, dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pathemeltë, si dhe të vërtetohet urdhri përbarues i Përbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-

së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm/faturat- Faturën nr.01/2023 të datës 23.01.2023 dhe Faturën nr.04/2023 të datës 26.04.2023, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, poashtu ka evidentuar se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturat e lartcekura në shumën e përgjithshme prej 11,915.00 Euro, në origjinal së bashku me propozimin, nga e cila shumë debitori ka arritur që të bëjë pagesën e pjesshme nga borxhi që rrjedh nga faturat e lartcekura, dhe se borxhi i mbetur është 9,515.00 Euro, fakt i cili vërtetohet nga propozimi për përmbartim i kreditorit, i bashkëngjitur në shkresat e lëndës.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit, pra rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1028/23, me datë 29.01.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.